



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:**  
Ndërmarrja Publike „Strezhevo“ Manastir

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë

**Qëllimi i revizionit:** Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- nuk është vendosur sistem i plotë për kontrollin e mënyrës se si përdoruesit harxhojnë ujin për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore;
- për një pjesë të objekteve që janë pjesë përbërëse e rrjetit të sistemit të ujitjes, pronësia e pronës nuk është e rregulluar;
- nuk është bërë regjistrim i plotë;
- mungojnë të dhënat për masat e ndërmarra për arkëtimin e kërkesave kontestuese dhe të dyshimta;
- parregullsi gjatë llogaritjes së pagave të punonjësve dhe dokumentacion i papërdorur i projektit për sanimin e ndryshimeve erozive në truallin rreth kanalit kryesor të furnizimit.

**Mendimi i dhënë\*:**



Mendim me rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

**Rekomandimet kyçe:**

- të ndërmerren masa për vendosjen e kontrollit të plotë mbi arkëtimin e të hyrave;
- të vazhdohet me aktivitetet për sigurimin e fletë pronësisë;
- t'i kushtohet më shumë rëndësi mënyrës se si bëhet regjistrimi dhe monitorimi i kërkesave, maturimi i tyre për arkëtim dhe vjetërsimi si dhe marrja në kohë e masave para gjykatave kompetente; dhe
- të rregullohet pagesëa e pagave për punonjësit.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

Nevojiten ndryshime ligjore dhe nënligjore për të rregulluar:

- shumën e kompensimit për ujitje, bazën për llogaritjen e kompensimeve për përdorimin e ujit për ujitje dhe prodhimin e energjisë elektrike dhe
- procedura për ankande publike pozitive gjatë shitjes së energjisë elektrike.

**Vërejtjet e marra të Draft-Raportit:**

Nuk janë marrë vërejtje të Draft-Raporti i RASH numër 17-180/9 prej 14.09.2021.



pozitive,



me rezervë



të pavolitshëm,



të përmbajtur